Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera – Office of the Prime Minister

ASK AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVES AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

2014 REGJISTRIMI I BUJQËSISË POPIS POLJOPRIVREDE AGRICULTURE CENSUS

REGJISTRIMI I BUJQËSISË - AGRICULTURE CENSUS - POLJOPRIVREDNI POPIS

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr.04/l-127 për Regjistrimin e Bujqësisë, të Ligjit Nr.04/L-36 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, ku Regjistrimi i Bujqësisë do të realizohet sipas metodologjisë tradicionale (derë më derë) përmes pyetësorëve, regjistrimi do të bëhet në të gjitha ekonomitë familjare në vendbanimet rurale ndërsa ne vendbanimet urbane në ndërmarrjet bujqësore dhe ekonomitë familjare të cilat kanë aktivitet bujqësorë. Andaj Agjencia e Statistikave të Kosovës angazhon një numër të konsiderueshëm të personelit dhe shpallë:

K O N K U R S

Për realizimin e Regjistrimit të Bujqësisë 2014, për këto pozita:

Titulli**: KONTROLLOR**

Numri i referencës**: ASK-RB-02**

Numri i pozitave sipas zyrave rajonale të statistikave të Kosovë:

1. Prishtinës: 130 Pozita: prej tyre 14 pozita janë rezervë dhe 15 pozita për komunitete
   (Prishtinë: 25 aktiv, 3 rezervë; Gllogoc: 19 aktiv, 2 rezervë; Fushë Kosovë: 8 aktiv, 1 rezervë; Lipjan: 17 aktiv, 2 rezervë; Novo Bërdë: 5 aktiv, 1 rezervë; Obiliq: 8 aktiv, 1 rezervë; Podujevë: 25 aktiv, 3 rezervë; Graçanicë: 9 aktiv, 1 rezervë)

2. Mitrovicë: 70 Pozita: prej tyre 11 pozita janë rezervë dhe 17 pozita për komunitete
   (Mitrovicë: 13 aktiv, 2 rezervë; Leposaviq: 5 aktiv, 1 rezervë; Skenderaj: 14 aktiv, 2 rezervë; Vushtrri: 18 aktiv, 2 rezervë; Zubin Potok: 3 aktiv, 1 rezervë; Zveçan: 4 aktiv, 1 rezervë; Mitrovicë Veriore: 2 aktiv, 2 rezervë)

3. Pejë: 52 Pozita: prej tyre 6 pozita janë rezervë dhe 3 pozita për komunitete
   (Pejë:19 aktiv, 2 rezervë; Istog: 15 aktiv, 2 rezervë; Klinë: 12 aktiv, 2 rezervë)

4. Gjakovë: 55 Pozita: prej tyre 7 pozita janë rezervë
   (Gjakovë: 17 aktiv, 2 rezervë; Deçan: 12 aktiv, 2 rezervë; Rahovec: 17 aktiv, 2 rezervë; Junik: 2 aktiv, 1 rezervë)

5. Prizren: 92 Pozita: prej tyre 13 pozita janë rezervë dhe 17 pozita për komunitete
   (Prizren: 31 aktiv, 6 rezervë; Dragash: 14 aktiv, 2 rezervë; Suharekë: 18 aktiv, 2 rezervë; Malishevë: 15 aktiv, 2 rezervë; Mamushë: 1 aktiv, 1 rezervë)

6. Ferizaj: 57 Pozita: prej tyre 8 pozita janë rezervë dhe 6 pozita për komunitete
   (Ferizaj: 24 aktiv, 3 rezervë; Kaçanik: 9 aktiv, 1 rezervë; Shtime: 8 aktiv, 1 rezervë; Shtërpcë: 5 aktiv, 2 rezervë; Hani i Elezit: 3 aktiv, 1 rezervë)

7. Gjilan: 59 Pozita: prej tyre 9 pozita janë rezervë dhe 11 pozita për komunitete

(Gjilan: 17 aktiv, 2 rezervë; Kamenica: 12 aktiv, 2 rezervë; Viti: 14 aktiv, 2 rezervë; Ranillug: 3 aktiv, 1 rezervë; Partesh: 2 aktiv, 1 rezervë; Kllokot:2 aktiv, 1 rezervë)

Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Kontrollimi i ecurisë së punës së regjistruesve në zonën e një **KONTROLLORI** (nga disa Zona Regjistruese) sipas rekomandimeve të marra nga ASK-ja .
2. Të merr pjesë në trajnim, të organizoj dhe të kryej trajnimin e regjistruesve,
3. Të shpërndaj dhe të mbledhë materialet e regjistrimit nga regjistruesit.
4. Të monitoroj punën e regjistrimit dhe cilësinë e punës së regjistruesve në terren.
5. Të raportojë në baza ditore për mbulueshmërinë e regjistrimit tek mbikëqyrësi dhe së bashku me mbikëqyrësin të përpilojë raportet e të dhënave paraprake.
6. Të vlerësojë punën e regjistruesve të tij .
7. Të mbaj komunikim të drejtpërdrejtë me mbikëqyrësit .
8. Raporton me shkrim dhe gojarisht tek mbikëqyrësi (në baza ditore, javore dhe sipas nevojës) për dinamikën e kryerjes së punëve.
9. Kryen edhe punë të tjera sipas udhëzuesit për kontrollor dhe metodologjisë së Regjistrimit të Bujqësisë.

Kriteret:

Për të qenë i kualifikuar për punën e kontrollorit në Regjistrimin e Bujqësisë 2014, kandidati duhet të:

Përmbush kriteret OBLIGATIVE:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
2. Të jetë i moshës madhore (Person i rritur por jo më i vjetër se 65 vjeç)
3. Mos të jetë i dënuar dhe mos të jetë nën hetime
4. Të ketë diplomë universitare.
5. Ta njoh dhe të jetojë në territorin e komunës dhe vendbanimin -et ku do të vepron gjatë RB. Ky informacion duhet cekur në aplikacionin për punësim
6. Të kenë telefon celular (aktiv)
7. Të kenë dorëshkrim të lexueshëm

Kriteret shtesë që kandidatëve iu japin përparësi :

1. Të kenë diplomë universitare,
2. Fakulteti i Bujqësisë, Veterinarisë dhe Pylltarisë
3. Përvojë pune në arsim
4. Përvojë pune në ASK në tri vitet e fundit
5. Pjesëmarrja në Regjistrimin e Popullsisë 2011
6. Pjesëmarrja në Regjistrim Testues të Bujqësisë 2012
7. Të ketë patentë shofer
8. Të ketë veturë në dispozicion për shfrytëzim gjatë kohës së angazhuar
9. Të papunësuar

Kohëzgjatja e punës

Personi në cilësinë e Kontrollorit do të angazhohet në kohëzgjatje prej 1 muaj e gjysëm në periudhën duke filluar nga 15.10.2014 deri më 30.11.2014

Pagesat mbulojnë, mbikëqyrjen e punës së/regjistruesve gjatë regjistrimit, numërimin e materialit deri tek dorëzimi i tyre dhe raporteve (përfshirë trajnimin, shpenzimet e transportit dhe telefonit). Pagesa për punën e kryer bëhet konform buxhetit të RB. Kontrollori rezerve ne rast të aktivizimit të tij/saj, kandidati do të paguhet si Kontrollor aktiv.

Procedurat e Aplikimit

Kandidatet e interesuar duhet të aplikojnë në zyra rajonale të ASK-së (**Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan**)

Aplikacionet mund të shkarkohen (merren) në ueb faqen e ASK-së në adresën: http://ask.rks-gov.net apo të shtypura mund të merren dhe dorëzohen në të gjitha zyrat rajonale të ASK-së.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit obligativ, që janë: Dokument identifikimi, vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime; vërtetime kualifikimi, patentë shoferi dhe vërtetimet për përvojën e punës së kërkuar për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Referencat tjera mund t'i bashkëngjiten aplikacionit si shtesë dokumentacionit të kërkuar ndërsa për pjesëmarrje në regjistrim 2011, dhe regjistrim testues të bujqësisë 2012, nuk ka nevojë për vërtetime pasi që ASK-ja disponon shënime për pjesëmarrësit.

Aplikacionet pranohen nga data 16.06.2014 deri më datën 30.06.2014 në ora 09:00- 15:00 në kopje fizike (*printuar*) në adresën:

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave –Prishtinë
(Komuna: Prishtinë, Podujevë, Fushë-Kosovë, Gllogoc, Lipjan, Graqanicë, Obiliq, Novobërdë)
Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu", Nr.4

ASK-Zyra Rajonale e Statistikave –Mitrovicë
(Komuna : Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica e Veriut, Zveçan)
Adresa;''Sheshi Agim Hajrizi (Shtëpia e Mallrave)-Mitrovicë

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave –Pejë
(Komuna : Pejë, Istog, Klinë)
Adresa; Rr. 'Adem Jashari'' Nr-174 (Rrokaqielli) kati i parë-Pejë

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave –Gjakovë
(Komuna : Gjakovë, Rahovec, Junik, Deçan)
Adresa:Rr.''Marin Barleti"Nr-2 Gjakovë

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave –Prizren
(Komuna :Prizren, Dragash, Mamushë, Malishevë dhe Suharekë)
Adresa: Rr.''Marin Barleti"P/N -Prizren

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave –Ferizaj
(Komuna :Ferizaj, Shtime, Kaçanik , Hani i Elezit, Shtërpcë)
Adresa:Rr."12 Qershori"(afër rrugës së tregut të gjelbër) Ferizaj

ASK- Zyra Rajonale e Statistikave – Gjilan
(Komuna: Gjilan, Kamenicë, Kllokot, Viti, Partesh, Ranilug)
Adresa:Rr."Isa Boletini"(pas stacionit të autobusëve) Nr.80- Gjilan

Informatë e përgjithshme .

Kërkesat e dërguara pas afatit (datës) së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të thirren për testim dhe intervistë .

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistës. Kandidatët do të njoftohen për datën dhe kohën e testimit dhe intervistave.

Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni Agjencinë e Statistikave të Kosovës , zyra nr. 25, tel: 038- 200-31-120, prej orës 09:00 – 15: 00. Në zyrat rajonale të ASK-së apo përmes faqes së internetit të ASK-së http://ask.rks-gov.net (Departamenti i Bujqësisë – vegëza për Regjistrimin e Bujqësisë ku gjendet materiali -Udhëzuesi dhe Pyetësori për përgatitjen e testit).

Agjencia e Statistikave të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Sipas metodologjisë së Regjistrimit të Bujqësisë, kontrollorët duhet të jenë nga vendbanimi dhe zona e regjistrimit ku ata jetojnë, ku 85% të pozitave të kërkuara do të pranohen nga vendet rurale. ASK-ja kërkon kandidatë të cilët janë komunikativ të gatshëm për punë ekipore të cilët aplikojnë në pozitat e kërkuara.